



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



**Nr. 11**  
**Dt. 02.02.2015**

## **DREJTORIA E ARSIMIT**

### **N J O F T I M**

**PËR TË GJITHË KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR PËR MËSIMDHËNËS NË  
KONKURSIN E DATËS 02.01.2015**

Kushdo që konsideron së është bërë ndonjë gabim ose lëshim teknik në databazen e konkursit, të dt. 05.01.2015 për mësimdhënës në DKA, mund të ushtrojë ankesë në afat prej pesë (5) ditësh: prej **02.02.2015 deri me 06.02.2015** në DKA, e cila do të kthejë përgjigje brenda afatit ligjor.

Në rast se, pas ankesave tuaja, verifikohet se ka pasur lëshime teknike, të njëjtit do të ftohen në Intervistë. Kjo në asnjë mënyrë nuk prejudikon rezultatin përfundimtar gjatë intervistimit. Prandaj, edhe data-baza me përmirësime do të publikohet pas shqyrtimit të ankesave.

Për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit).

- Kandidatët e përzgjedhur për intervistim janë kandidatët e parë, rreshtat e të cilëve janë hijezuar fund e krye me ngjyrë të kuqe.
- Kandidatët që janë të hijezuar fund e krye me ngjyrë të kaltër janë kandidatë që janë përzgjedhur për t'u intervistuar në ndonjë pozitë tjetër, meqë kanë aplikuar në më shumë se një pozitë, në ndërkohë që mund të ftohet në vetëm një vend/pozitë për intervistim.

**Vërejtje:** Të gjitha ankesat e pakjarta dhe ato jashtë këtij afati zyrtar nuk do të shqyrtohen

Me respekt,

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Faqe 1 nga 1